R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**BASHKIA PATOS**
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

**Nr._____Prot .** **Patos, më ___/___/2025**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

*[19.08.2025]*

**Drejtuar: "ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k** me nr. **NIPT J61812013R** me Tirane, Kryqëzimi i Rruges Liman Kaba me Prokop Mima, Rezidenca Olimpik, Shkalla nr 3, Kati 2.

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** ☐

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO*** ***X***

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** **X** **JO** ☐

**"METEO" SH.P.K** me nr. Nipti: L26310801C me adresë: Fshati Cekin, Rruga Nacionale Gramsh-Elbasan, ndërtesë private, zona kadastrale Nr. 1362, nr. pasurie 6/76, pranë uzinës Gramsh.

Tipi i Kontratës: **Punë.**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Tender i hapur.**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-58232-08-15-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* **"Rikonstruksion i blloqeve të banimit në lagjen 1 Maj për vitet 2025, 2026 dhe 2027"**.

Afati: **12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.**
Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **18.08.2025**
Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]:* Buletini Nr. 46 datë 25 gusht 2025.

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **OE "AGI KONS" sh.p.k** me nr. **NIPT K21622001M** ofron vlerën sipas preventivit **113,376,281.24 (njëqind e trembëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pikë njëzetë e katër)** lekë pa TVSH.

  OE/BOE me nënkontraktor

  PO □ JO X

  *Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

  *(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

- **OE "ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k** me nr. **NIPT J61812013R** ofron vlerën sipas preventivit **141,015,000 (njëqind e dyzetë e një milion e pesëmbëdhjetë mijë)** lekë pa TVSH.

  OE/BOE me nënkontraktor

  PO □ JO X

  *Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

  *(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

- **OE "FRONTIER CONSTRUCTION" sh.p.k** me nr. **NIPT M11811020Q** nuk ka ofruar asnjë ofertë ekonomike.

  OE/BOE me nënkontraktor

  PO □ JO X

  *Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

  *(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

- **BOE "LIQENI VII" sh.p.k** me nr. **NIPT K01730502W** dhe **"KTHELLA" sh.p.k** me nr. **NIPT J69303023D** ofron vlerën sipas preventivit **129,486,856.8 (njëqind e njëzetë e nëntë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetë)** lekë pa TVSH.

  OE/BOE me nënkontraktor

  PO □ JO X

  *Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

  *(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

- **OE "LIS KONSTRUKSION" sh.p.k** me nr. **NIPT K66613407H** ofron vlerën sipas preventivit **144,770,293.50 (njëqind e dyzetë e katër milion e**

**shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë)** lekë pa TVSH.
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

- **OE "SHENDELLI" sh.p.k** me nr. **NIPT K07924803N** ofron vlerën sipas preventivit **126,057,267 (njëqind e njëzetë e gjashtë milion e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë)** lekë pa TVSH.
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

- **OE "AGI KONS" sh.p.k** me nr. **NIPT K21622001M** s'kualifikohet sepse nuk plotëson kriteret si më poshtë:

1- **Pikat 2.11.2** Operatori ekonomik per materialet (gjeotekstil 165 g/m$^2$, panel sandwich, Rezine poliutireni me ngjyre e perzier me gome te granuluar e hedhur me dy shtresa, shtresa baze gome, Shatervan me 6 hedhje (pompa kolektor, panel elektrik, tuba rakorderi element ndricimi) referuar zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike duhet te paraqesi:

**2.11.3** Per pajisjet/materialet ne piken 2.11.2, operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me te cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompanine pjesemarrese ne tender te ofertoje keto pajisje/materiale. Ne rast paraqitje autorizim distributori te autorizuar duhet te paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit per materialet kryesore te kerkuara.

**2.11.4** Të paraqiten kataloget nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit te autorizuar nga prodhuesi, per te gjitha pajisjet/materialet sipas pikes 2.11.2 Ne kataloge duhet te markohet me ngjyre te qarte pajisja/materiali qe ofrohet dhe te pasqyrohen specifikimet teknike te kerkuara per keto pajisje/materiale.
*Shenim: Fleta ose fletete katalogut qe pasqyrojne specifikimet teknike te kerkuara te pajisjes/materialeve duhet te paraqiten ne gjuhe shqipe, te perkthyera dhe te noterizuara.*

- **Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori nga Al-Steel Construction 01 shpk mbi listën e materialeve: panel sandwich, hekur, tuba metalik.**
- **Autorizim prodhuesi nga Elastron S. A ag. Ioannis street Ag. Ioannis, mbi panelet (anglisht-shqip), autorizim mbi GALVANIZED METAL CONSTRUKSION (anglisht). Pra sa më sipër operatori ekonomik ka**

paraqitur dokumentacionin autorizim prodhues lidhje me distributor vetëm për panelet.

- Për Hekur është paraqitur vetëm autorizim distributori në anglisht (faqa 6 e lidhjes).

**Referuar pikës 4.7 të DST 4.7 parashikohet:**

**Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

**Shqip X** **Anglisht** 

**Sa më sipër, operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi pikën 2.11.2 dhe 4.7 (*sipercituar*) të DST për HEKUR referuar kriterit :**
***Per pajisjet/materialet ne piken 8, operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me te cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompanine pjesemarrese ne tender te ofertoje keto pajisje/materiale. Ne rast paraqitje autorizim distributori te autorizuar duhet te paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit per materialet kryesore te kerkuara.***

**-Operatori ekonomik nuk ka paraqitur lidhje prodhues distributor për tubat metalik në procedurën objekt prokurimi. Akoma më tej, Al-Steel Construction 01 shpk është distributor dhe katalogët e hedhur në sistem nuk janë paraqitur të prodhuesit referuar dhe faqes zyrtare https://www.elastron.gr/gr/en/home/. Nga verifikimi në këtë faqe si prodhues i mallrave objekt prokurimi, vihet re që nuk ka katalog të mallrave objekt prokurimi në shqip dhe aq më tepër të distributorëve.**

- **Referuar markimit në katalogët e paraqitur nga operatori ekonomik mbi panelet vihet re qartësisht se nuk plotësohet kriteri mbi përcjelljen termike ku në specifikimet teknike kërkohet përcjellja termike 0.02089 W/mk, në katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik është 0.02065 W/mk (jo në përputhje me specifikimet teknike) si dhe nuk plotëson kriterin mbi transmetimin termik ku në DST kërkohet 0.42 W/m2 K ,në katalogun e paraqitur transmetimi termik është 0.41 W/m2 K (Faqa 30 e lidhjes e markuar nga vetë operatori)**

  **Sa më sipër, Operatori ekonomik AGI nuk plotëson kriteret e kualifikimit mbi Panelet, Hekur, Tuba metalik.**

- **Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion sipas pikës 2.11.2. , 2.11.3 2.11.4 për *Diza tip Spring me pllake mbulimi e shkeleshme me prurje Q=47 l/min dhe prevalence 2.6 m, cdo dize eshte e pajisur me 2 drita LED 9 W - 24 V DC - IP68*.**

**Referuar sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e kualifikimit dhe oferta e tij ekonomike skualifikohet.**

**-Gjithashtu operatorit ekonomik nuk i hapen në sistem disa foldera si : Pasqyra Financiare e Vitit 2022, Pasqyra Financiare e Vitit 2023, Pasqyra Financiare e Vitit 2024, si dhe vërtetim xhiro.**
**Por nisur nga fakti se operatori ekonomik “AGI CONS” sh.p.k s’kualifikohet sepse nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.11.2. , 2.11.3 2.11.4 “Kapacitetet teknike”, Komisioni i Vlerësimit gjykon se nuk do të merren në shqyrtim dokumentacioni mbi moshapjen e dokumentacionit të**

**mësipërm nëse është hedhur apo jo sipas formatit ligjor, nëpërmjet verifikimit pranë Agjencisë së Prokurimit Publik pasi, referuar sa më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik nuk do të ndryshojë, mbetet i skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht verifikimi mbi këto dokumentacione nuk e ndyshon atë.**

- **OE “FRONTIER CONSTRUCTION” sh.p.k** me nr. **NIPT M11811020Q** s’kualifikohet pasi nuk plotëson kriteret si më poshtë:

  **OE “FRONTIER CONSTRUCTION” sh.p.k nuk ka ngarkuar asnjë dokumentacion të kërkuar në sistem.**

- **BOE “LIQENI VII” sh.p.k** me nr. **NIPT K01730502W** dhe **“KTHELLA” sh.p.k** me nr. **NIPT J69303023D** s’kualifikohet pasi nuk plotëson kriteret si më poshtë:

1- **Pikën 2.12** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme),
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme)
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalenten ISO 45001-2023 (e vlefshme)

**Nga verifikimet në sistem rezulton se Çertifikatat ISO të OE “KTHELLA” sh.p.k janë të pavlefshme pra “NON VALID-PEZULLUAR”. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.**

Company name: "KTHELLA" SHPK NIPT: J69303023D
Address: Kompleksi Kthella Resort, Rruga "Shen Vinçenso De Paolo", përballe varrezave te qytetit Rreshen, Rreshen, Albania.
Standard: EN-ISO 9001:2015
First issue 18/03/2017
Modification no and date Recertification / Ricertifikimi 18/03/2023
Expiry date: 17/03/2026
Number of certificate: AQS/Q/99912023
Scop: Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile dhe industriale, terrene sportive, ujësjellesave, kanalizimeve, vepra kullimi e ujitje, hidrocentrale, mbrojtje lumore, sisteme hidraulike, konstruksione e mbulesa speciale çeliku dhe betonarme. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje te infrastrukturës rrugore dhe sheshevе. Punime gjeologjike dhe gjeoteknike. Shpime gjeologo-inxhinierike. Punime gjeodezike dhe topografike. Punime sinjalistike. Punime elektrike të tensionit të ulët, mesëm dhe të lartë. Punime elektronike dhe elektroteknike (internet, telefoni, IT). Punime të inshinierisë mjedisore & ambientale (punime gjelbërimi, mbjellje pemësh e fidane, landfilld, prodhim i fidaneve i luleve dhe pemeve dekorative). Restaurim të ndërtesave civile dhe industriale, shesheve, rrugëve, muzeve, ndërtesave të rëndesisë të veçantë. Punime të gurëve natyrorë dhe dekorativë. Prodhim i materialeve të ndërtimit (betone, llaçra, bordura, pllaka e elemente te parafabrikuara të betoneve, gurë natyrorë, inerte, tuba betoni dhe betonarme te formave e dimensioneve te ndryshme). Prodhim dyer, dritare, vetrata, fasada e elemente te ngjashem duralumini e druri. Tregëtim karburanti e gazi të lëngët. Shërbime të pastrimit dhe gjelberimit të hapësirave publike. Shërbime të shfrytëzimit të pyjeve, kullotave dhe sherbimeve që lidhen me to. Grumbullim, transportim, përpunim, riciklim i mbetjeve urbane.
Scop: Construction and reconstruction of civil and industrial buildings, sports grounds, water supply systems, sewerage, drainage and irrigation works, hydropower stations, river embankments, hydraulic systems, special constructions and coverings steel and reinforced concrete. Construction, reconstruction and maintenance of road infrastructure and squares. Geologic and geotectonic works. Drilling of geological-engineering. Geodetic and topographic works. Signaling works. Electrical works at low, medium and high voltage. Electronics and electra technical works (internet, telephony, IT). Works of environmental engineering (greenery works, planting of trees and seedlings, landfills, production of seedlings, flowers and decorative trees). Restoration of civil and industrial buildings, squares, streets, museums, importance special buildings. Working of natural and decorative stone. Production of construction materials (concrete, mortar, borderless, plates and prefabricated concrete elements, natural stones, aggregates, concrete pipes and reinforced concrete of different dimensions and forms). Manufacturing of doors, windows, glass windows, facades and similar duralumin and wood elements.Trading of fuel and liquefied gas. Cleaning services and green spacespublic. Services forest exploitation, grazing and services associated with them. Collection, transportation, processing, recycling of waste.
Validity: NON VALID - E PEZULLUAR

- **Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi/lidhje prodhues distributor, katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributor të autorizuar nga prodhuesi, për** ***Diza tip Spring me pllake mbulimi e shkeleshme me prurje Q=47 l/min dhe prevalence 2.6 m, cdo dize eshte e pajisur me 2 drita LED 9 W - 24 V DC - IP68.***

- **Bashkimi i operatoreve ekonomik nuk provon lidhje autorizim prodhues/distributor/ katalog për pompën pasi është paraqitur autorizim distributori nga Sali elektrik, autorizim prodhuesi nga PEDROLLO S.p.a kurse katalogu i përket Vortex.**

➤ **OE "LIS KONSTRUKSION" sh.p.k** me nr. **NIPT K66613407H** s'kualifikohet sepse nuk plotëson kriteret si më poshtë:

1- **Pikën 2.7** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Transport
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder

**Stafi inxhinierik i deklaruar nga ana e Operatorit Ekonomik konkretisht z. Jetjon Tahiraj me profesion Inxhinier Ndërtimi, znj. Lumturi Ejupi me profesion Inxhiniere Ndërtimi, z. Ilia Budri me profesion Inxhinier Topograf, z. Elton Rroshi me profesion Inxhinier Elektrik, rezultojnë të deklaruar nga ana e Operatorit Ekonomik edhe në procedurën e tenderit me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re", procedurë në të cilën OE "LIS KONSTRUKSION" është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë me Bashkinë Patos.**

2- **Pikën 2.10** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave:

**Stafi teknik i deklaruar nga ana e Operatorit Ekonomik rezultojnë të njëjtë me stafin teknik të deklaruar nga ana e Operatorit Ekonomik edhe në procedurën e tenderit me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re", procedurë në të cilën OE "LIS KONSTRUKSION" është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë me Bashkinë Patos.**

3- **Pikën 2.11** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

**Mjetet dhe pajisjet e deklaruar nga ana e Operatorit Ekonomik rezultojnë të njëjta me mjetet dhe pajisjet e deklaruara nga ana e Operatorit Ekonomik "LIS KONSTRUKSION" edhe në procedurën e tenderit me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të Bllokut të Vreshtit, Lagja e Re", procedurë në të cilën OE "LIS KONSTRUKSION" është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë me Bashkinë Patos.**

- **OE "SHENDELLI" sh.p.k** me nr. **NIPT K07924803N** s'kualifikohet sepse nuk plotëson kriteret si më poshtë:

**-Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi pikën 2.11.2. , 2.11.3 2.11.4 "Kapaciteti teknike" mbi Pompat pasi në sistem është paraqitur autorizim distributori nga Admir Dida PF.**

**Admir Dida PF është distributor i autorizuar nga Star Pompa SAN. VE TIC.LTD.STI si prodhues por autorizimi i prodhuesit është jashtë afatit të procedurës. Sipas autorizimit të paraqitur në SPE ky autorizim është i vlefshëm deri më 31.12.2024 dhe mund të rinovohet, ku në SPE nuk është paraqitur një autorizim i ri nga prodhuesi kundrejt distributorit të autorizuar.**

**Sa më sipër operatori nuk plotëson kriterin mbi pikën 2.11.3.**

**Akoma më tej referuar katalogëve të paraqitur nga Operatori ekonomik pompat e paraqitura janë pompa zjarri dhe pompa nafte dhe jo ato të kërkuara në specifikimet teknike në DST.**
**Sa më sipër, ju nuk plotësoni kriterin mbi pikën 2.11.2 , 2.11.3 dhe 2.11.4 mbi pompat e kërkuara sipas DST.**

**-Operatori ekonomik nuk ploteson kriterin mbi Panelet Sandwich. Referuar dokumentave standarte të tenderit kërkohen specifikimet teknike si më poshtë:**

***Mbulimi i struktures do te behet me panel sanduic 5 cm, I cili duhet te përputhet me kushtet per ekzekutim sipas detajtit te projektit të konstruksionit metalik, i cili përballon të gjitha ndikimet nga shfrytezimi normal dhe ndikimit mjedisor. Përdorim lënde termoizoluese polyurethane, i shkrirë me flake duke perfituar një adezion perfekt në përputhje me standartet e kohës të ISO.***

- ***Densiteti mesatar: 35 – 40 kg/m3***
- ***Përcjellja termike: 0.02089 W/mk***
- ***Transmetimi termik: 0.42 W/m2 K***
- ***Rezistenca termike: 2.39 m2 K/W***

**Referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE ju nuk keni paraqitur panel sandwich për mbulimin e strukturës sipas kërkesave mbi specifikimet teknike të parashikuara në DST. Paneli i paraqitur ng ana juaj është Frigo i prodhuesit Arkhon për sigurinë ushqimore dhe Horizon për vendosje vertikale dhe horizontale dhe jo për mbulim strukture (sky).**

**Akoma më tej, nga verifikimi i katalogëve të paraqitur nga operatori ekonomik nuk plotëson asnjë prej kritereve mbi densitetin, përcjelljen termike, etj.**

**Komisioni në verifikim të faqes zyrtare të prodhuesit https://arkhonpanel.com/ konstatoi se ky prodhues nuk disponon katalog mbi panelet në gjuhën shqipe.**

**Sa më sipër nuk plotësoni kriterin mbi panelet Sandwich.**

- **Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi paraqitjen në përputhje me specifikimet teknike të Rezine poliutireni me ngjyre e perzier me gome te granuluar e hedhur me dy shtresa, shtresa baze gome.**
  **Në dokuementacionin e dorëzuar në SPE keni paraqitur autorizim distributori nga Anuar Construction shpk dhe autorizim prodhuesi nga Inegral Entegre Yapi Teknolojileri San. Ve Tic A.S.**
  **Katalogu i paraqitur nuk përmban element të specifikimeve teknike të kërkuara në DST dhe akoma më tej katalogu i paraqitur nuk përmban asnjë element që i përket prodhuesit Inegral Entegre Yapi Teknolojileri San. Ve Tic A.S.**

**Nga verifikimi i faqes së prodhuesit https://www.integralgrass.com/turkey/ konstatuam se nuk gjenden katalog të prodhuesit në gjuhën shqipe.**

- **Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi panelet elektrik sipas kërkesave të DST. Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori nga Brika Elektrik shpk ku ky i fundit ka autorizim prodhuesi nga SCHNEIDER ELECTRIC BULGARIA EOOD a subside of SCHNEIDER ELECTRIC INDUSTRIES SAS (anglisht)**
  **Referuar pikës 4.7 të DST 4.7 parashikohet:**

**Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

**Shqip X** **Anglisht □**

**Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumetacionin në perputhje me kriteret e kualifikimit.**

- **Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret mbi Diza tip Spring me pllake mbulimi e shkeleshme me prurje Q=47 l/min dhe prevalence 2.6 m, cdo dize eshte e pajisur me 2 drita LED 9 W - 24 V DC - IP68 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për to.**

**Referuar sa më sipër oepratori ekonomik nuk plotëson kriteret mbi pikën 2.11.2, 2.11.3 dhe 2.11.4 të kërkuara sipas DST.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE [“ALBA KONSTRUKSION” sh.p.k** me nr. **NIPT J61812013R** me Adresë: Tirane, Kryqezimi i Rruges Liman Kaba me Prokop Mima,Rezidenca Olimpik,Shkalla nr 3, Kati 2], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej [**141,015,000 (njëqind e dyzetë e një milion e pesëmbëdhjetë mijë)** lekë pa TVSH] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i suksesshëm. ***me Subjekt Mbështetës:***
**“METEO” SH.P.K** me nr. Nipti: L26310801C me adresë: Fshati Cekin, Rruga Nacionale Gramsh-Elbasan, ndërtesë private, zona kadastrale Nr. 1362, nr. pasurie 6/76, pranë uzinës Gramsh,

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

**KRYETARI**
**Fation Duro**